

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

ZYA E SUPERINTENDENTIT

440 NORTH BROAD STREET, SUITE 301

PHILADELPHIA, PENNSYLVANIA 19130

WILLIAM R. HITE, JR., Ed.D.
SUPERINTENDENT

TELEFON (215) 400-4100
FAX (215) 400-4103

7 Janar 2016

Të dashur Prindër/Kujdestarë:

Drejtoria Arsimore e Filadelfias paraqet çdo vit Progres Raportin e Shkollës (SPR). SPR është si një lloj “dëftese” për secilën shkollë. Ai përmban informacione për arritjet mësimore të shkollës dhe përdoret si udhërrëfyes për rrugët e përmirësimit të shkollës. Sot po paraqesim SPR_të për vitin shkollor 2014-15 .

SPR ofron informacion për anët e forta dhe pikat e dobëta të shkollave publike dhe ato charter të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias. Padyshim kjo na ndihmon ne të ndjekim progresin drejt synimeve që 100 % e fëmijëve tetëvjeçarë të jenë të aftë në leximin e nivelit të klasës së parë dhe 100% e nxënësve të jenë të gatshëm për kolegji dhe karrierë, si edhe në synimin tonë që të garantojmë për çdo fëmijë një shkollë të nivelit të lartë në zonën ku ai jeton.

SPR i vlerëson shkollat në shumë fusha të veprimtarisë, duke përfshirë arritjet mësimore, përmirësimin e nxënësve, klimës së shkollës dhe për shkollat e mesme edhe përgatitjet për kolegji, ose gatishmërinë për punësim. Nga rezultatet e marra, çdo shkollë do të përfshihet në një prej katër kategorive të performancës: Model (më e larta), Në Përforsim (Reinforce), Në Vrojtje (Watch) dhe në Ndërhyrje (Intervene) (më e ulta).

Nga shqyrtimi i rezultateve të këtij viti shkollor, Unë jam i inkurajuar nga sukseset e disa shkollave dhe puna e mirë e të tjerave për përmirësimin e performancës. Megjithatë, rezultatet tona tregojnë gjithashtu edhe sfidat që shumë shkolla, veçanërisht ato të lagjeve duhet të përballojnë në vazhdim.

Gjatë këtij muaji, Drejtoria Arsimore do të publikojë një udhëzues të SPR për prindërit, i cili do të shpjegojë në detaje nivelet e shkollave të ndryshme, fushat ku kryhen matjet dhe se si rezultatet e SPR reflektohen në planet e përmirësimit të shkollës.

Nëpërmjet SPR, ju keni akses në më shumë informacion për progresin e shkollës, në arritjen e kërkesave të fëmijës tuaj. Unë shpresoj, që ju do të përdorni SPR që të rritni kuptimin dhe të sugjeroni ndryshime për performancën e shkollës tuaj.

Sinqerisht,



William R. Hite, Jr., Ed.D.